



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

**KOMUNA E GJAKOVËS**  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## **RREGULLORE**

**Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve**


**Maj- 2015**



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. \_\_\_\_\_/2015

Dt. 29.04.2015

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (c) dhe nenin 40.2 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenin 18.2 shkronja (a), të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.05.2015, pas diskutimit në pikën e 10-të të rendit të ditës: Të ndryshme, lidhur me rekomandimin e MAPL-së për rishikimin vendimit të Kuvendit 01 nr.011-31359 të dt.29.04.2015, e miratoi këtë:

### Rregullore

### Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve

#### Neni 1

Pas nenit 1 të rregullores bazike shtohet neni i ri me emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

#### Neni 1. A Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 01 nr. 011- 11268 e dt. 07.07.2014.

#### Neni 2

2.1 Nga neni 2 deri te neni 17 i Rregullores bazike, teksti i rregullores mbetet i pa ndryshuar .

2.2 Neni. 17 i Rregullores bazike kalon në renditje në nenin 18 dhe të gjitha nenet tjera pasuese renditen pas nenit 18, ndërsa në nenin 17 vendosen Subvencionet në Lëmin e Biznesit me këto shënime :

-Neni. 17. Subvencionet nga Lëmi i Biznesit:

-17. 1. Komuna ndanë subvencione në formë të përkrahjes financiare bizneseve me qëllim që të ndikoj në gjenerimin e vendeve të punës për ato projekte që do të përfitojnë nga këto subvencione. Subvencionet do të caktohen sipas kriterëve të caktuara nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve , për bizneset mikro, të vogla, dhe të mesme si dhe për bizneset e arti zanateve që para së gjithash e promovojnë trashëgimin kulturore tradicionale .

#### 17.2. Kriteret për ndarjen e Subvencioneve :

- a. Të jenë Biznese të Komunës së Gjakovës
- b. Të gjenerojnë punësim me marrjen e subvencioneve /grandit . Përparësi kanë Projektet Zhvillimore që gjenerojnë numër më të madh të vendeve të punësimit, të rrisin kapacitetet e biznesit , të ngrisin cilësinë e produktit, dhe shërbimeve që ofrojnë.
- c. Të dëshmojnë që Biznesi i tyre është i qëndrueshëm dhe Funkcional
- d. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në zyrën e regjistrimit të Bizneseve ( ARBK)
- e. Pjesëmarrja e përfituesit duhet të jetë 20 përqind (%) e vlerës së Projektit me të cilin aplikon, përveç në rastet kur në thirrjen për aplikim është specifikuar ndryshe .
- f. Projektet e bizneseve që janë të angazhuara në veprimtaritë në prodhim, përpunim dhe në zhvillim të artizanateve tradicionale do të kenë përparësi të subvencionimit nga ana e këtij fondi.  
Projekte të cilat promovojnë bashkëpunimin ndërkufitar Kosovë – Shqipëri, kanë përparësi në mbështetjen me subvencione nga ana Komunës
- g. Bizneset që udhëhiqen nga femrat dhe të rinjtë, do të kenë përparësi, kuotat për inkurajimin e bizneseve të tyre do të prezantohen në secilën thirrje për aplikim .
- h. Çdo kriter tjetër specifik që kërkohet në thirrje për aplikim.

#### 17.3. Përzgjedhja e Projekteve

- a. Përzgjedhja e projekteve bëhet nga Komisioni vlerësues i përberë prej 5 anëtarëve nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik , Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe 2 përfaqësues të Shoqërisë Civile ( Ekspert të pa varur në fushën e Biznesit apo të organizatave financiare).
- b. Projekti i përzgjedhur duhet të publikohet në faqen zyrtare të Komunës në mënyrë transparente.

#### 17.4. Monitorimi i përfitueseve të Subvencioneve :

- a. Përfituesit e subvencioneve obligohen që në periudhën kohore nga data e përfitimit të subvencioneve e deri në zbatimin e plotë të projektit , të raportojnë në baza 3 ( tre) mujore në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik për mënyrën e shfrytëzimit të subvencioneve dhe rezultatet e arritura.
- b. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë periudhës së Monitorimit, ka të drejt të vizitoj përfituesit rreth progresit të biznesit të tyre, dhe të kërkoj informacione për mënyrën e shfrytëzimit të tyre
- c. Të gjitha përgjegjësit dhe të drejtat e përfitueseve dhe të DZHE do të specifikohen në marrëveshjen e nënshkruar në mes të përfituesit dhe organeve Komunale.

### Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
01 nr. 011-57911, dt.28.05.2015



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Luan Gola